

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**AKT PËRCJELLËS**

Për:	Menaxherin e prokurimit Kuvendi i Komunes se Prishtines OE ankues “Autotaxi”Bujar Stublla”	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Flora Doda – Ekspert profesional i prokurimit 		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 281/19 të parashtruar nga OE “Autotaxi”Bujar Stublla”-Podujeve		
Datë	26.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt: 29.05.2019 me nr. 281/19 të parashtruar nga OE “Autotaxi”Bujar Stublla”lidhur me aktivitetin e prokurimit“Transporti i nxënësve dhe arsimtareve –Lot 4 “ me nr. të prokurimit: 616-19-1046-2-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes se Prishtines

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

**Ti dorëzohet:**


- Autoritetit Kontraktues – Kuvendi i Komunes se Prishtines
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues- “Autotaxi”Bujar Stublla”-Podujeve

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “Autotaxi”Bujar Stublla”-Podujeve lidhur me aktivitetin e prokurimit “Transporti i nxënësve dhe arsimtareve –Lot 4 “ me nr. të prokurimit: 616-19-1046-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes se Prishtines



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

**RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

		12.06.2019	26.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit		data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

**N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit**

Me datën: 05.06.2019 “Autotaxi”Bujar Stublla”-Podujeve ka parashtruar ankesë në OSHP , kundër njoftimit për anulim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Transporti i nxënësve dhe arsimtareve –Lot 4 “ me nr. të prokurimit: 616-19-1046-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi i Komunes se Prishtines

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

**Operatori Ekonomik Ankues “Autotaxi”Bujar Stublla”-Podujeve**

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues “Autotaxi”Bujar Stublla”-Podujeve janë:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,  
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,  
Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, dhe  
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale,

**DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:**

Unë auto taxi “Bujar Stublla” nuk kam dorëzuar kombi me 8 ulëse që më është thënë në arsyetimin e dhënë, dhe mendoj që është e pa vërtetë, se unë kam dorëzuar minibus të cilin e dëshmon edhe librezja e minibusit, sipas kërkesës që është kërkuar në dosjen e tenderit.

Arsyetimi i dytë sipas ligjit që ju kanë referuar (neni 3, pika 1.8) ku ky nenë thotë “Mjeti që shërben për transport të personave i cili përveç ulëses së shoferit ka më së shumti tetëulëse”, departamenti i prokurimit nuk e ka cituar nenin ashtu siç thotë por e ka ndryshuar pasi që e ka cituar “mjet për tu kategorizuar një mjet i tillë duhet që pos ulëse së vozitësit të ketë më shumë se tetë ulëse” (neni 3, pika 1.8). Ku unë mendoj që ka bërë shkelje të ligjit në bazë të nenit 3, pika 1.8 të Të Ligjit për rregullat e trafikut rrugorë.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga “Autotaxi”Bujar Stublla”-Podujeve lidhur me aktivitetin e prokurimit “Transporti i nxënësve dhe arsimtareve –Lot 4 “ me nr. të prokurimit: 616-19-1046-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes se Prishtines



Unë me këtë minibusë dhe këtë patën shofer ushtroj këtë veprimtari që tri vite, gjë të cilën e kam dëshmuar edhe me referenca nga AK.

Arsyet e eliminimit tim pas shpallje fitues janë ta pa baza dhe diskriminuere, të vlerësosh që nuk e kemi Patentë shofer për vozitjen e 8 nxënësve është një diskualifikim i pa bazë. Në dosjen e tenderit është kërkuar minibus me 8 ulëse, gjë që e plotësoj plotësisht. Minibusi im i ka 9 ulëse.

Patentë shoferi dhe librezë e minibusit dëshmojnë që unë i plotësoj kushtet e kërkuar në dosjen e tenderit.

Kategoria B e patentë shoferit është valide për Vozitja e Minibusit me 9 ulëse, bazuar në ligjin për patën shofer.

Kërkojmë nga AK që të bëjë vlerësimin e këtij tenderi edhe një herë.

### Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: .....11.03.2019

Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Vlere e mesme

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....08.04.2019

Data e hapjes së ofertave.....08.04.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....23.05.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm..... 06.05.2019

Data e njoftimit për dhënien e kontratës:.....23.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim..... 24.05.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim..... 27.05.2019

### Kriteret për vlerësim:

#### III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

1.Një dekaratë me shkrim nën betim e nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

2.Për situatën referuar pikës 6.3 [h(tatimit)],vërtetimi i lëshuar nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit, të operatorit ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesë tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para publikimit të Njoftimit për dhënie të Kontratës]

3. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d,e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d],vërtetim i lëshuar gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Deklarata nën betim

2.Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente vetëm për fituesin para dhënies së kontratës

3.Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore-vetëm për fituesin para dhënies së

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Autotaxi" Bujar Stublla"-Podujeve lidhur me aktivitetin e prokurimit "Transporti i nxënësve dhe arsimtareve -Lot 4 " me nr. të prokurimit: 616-19-1046-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes së Prishtinës

kontratës.

### III.2.2. Përshtatshmëria profesionale

- 1 Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndermarrjeve në vendin e juaj të themelimit.
2. Regjistrimi në regjistrin Fiskal për kompanitë vendore

#### Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Certifikata e biznesit-kopje.
2. Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal-Kopje

### III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për shërbime të ngjajshme (gjatë tri viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo më pak se Lot I-3000 €, Lot II-6000 €, Lot III-9000 €, Lot IV-9000 €

2. Operatori Ekonomik duhet të posedojë së paku 1 autobus për një linjë (LOT)

3. Operatori Ekonomik duhet të ketë së paku 1 vozitës për çdo relacion (LOT) me leje të kategorisë së automjetit.

#### Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të dosjes së tenderit ku duhet të saktësohet titulli i kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkangjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e shërbimeve.

2. Dëshmitë e autobusit –librezat e qarkullimit

3. Kopja e lejes me kategorinë e automjetit

### Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi		Vërejtje
----	---------------------	-------	--	----------



## Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- |                      |                        |
|----------------------|------------------------|
| 1. Vezir Bytyqi      | - Kryetar i Komisionit |
| 2. Ardijsana Ismajli | - Anetare              |
| 3. Jakup Ramadani    | - Anetar               |

### Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit rekomandon anulimin e këtij lloji pasi që OE-ik Bujar Stublla nuk plotëson kushtet e përshtatshmërisë e aftësive profesionale dhe për këtë aktivitet duhet të eliminohet.

Komisioni rekomandon për anulim dhe ritenderimin e këtij aktiviteti.

## Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "ARF"SH.P.K.-Fushe Kosove

### Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimet e OE ankues, janë se AK Kuvendi Komunal i Prishtinës ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 52 dhe 69 të LPP në fuqi, sepse AK e ka eliminuar Operatorin ekonomik ankues me pretendimin se nuk i plotëson kërkesat lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale konkretisht nuk e posedon kategorinë e vozitjes D1 dhe D dhe nuk e plotëson kërkesën për minibus sepse sipas Ligjit për komunikacion Neni 3 pika 1.8 Automjet udhëtarësh –mjet që shërben për transport të personave i cili përveq ulëses së shoferit ka me së shumti 8 ulëse, ndërsa ju keni ofruar mëtej për transport 8+1 ulëse.

Ekspertja profesionale e prokurimit konstaton se pretendimet e OE Ankues janë të bazuara për arsye se AK Komuna e Prishtinës tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nuk ka cekur numër të ulëseve vetëm ka kërkuar **Operatori Ekonomik duhet të posedojë së paku 1 minibus për një linjë (LOT)**, por vetëm në përshkrimin e Çmimeve është specifikuar që do të bëhet 8 nxënës, pastaj e ka eliminuar OE se nuk e plotëson këtë kriter sepse kategoritë që duhet të ketë Patent shoferi i OE duhet të jenë **Kategoria D1:**

**1.12.1. automjete të dizajnuara dhe të ndërtuara për bartje të jo më shumë se gjashtëmbëdhjetë (16) udhëtarëve dhe të shoferit**, ku gjatësia maksimale e tyre nuk e tejkalon gjatësinë prej tetë (8) m; automjetit mund t'i bashkëngjitet rimorkioja me masën më të madhe të lejuar deri në 750 kg; ose **kategoria D:1.14.1. automjetet e dizajnuara dhe të ndërtuara për bartje të më shumë se tetë (8) udhëtarëve dhe shoferit**; mund t'i bashkëngjitet rimorkioja me masën më të madhe të lejuar deri në 750 kg, .

Operatori ekonomik ka ofruar patente shoferin e kategorisë B dhe automjetin me 9 ulëse e duke u nisur nga kërkesa e AK për bartjen e 8 nxënësve Sipas Ligjit Ligji Nr. 05/L – 064 për patent shofer nuk është e nevojshme të ketë këto dy kategori sepse **Kategoria B: e 1.6.1. automjeti me masën më të madhe të lejuar deri në 3500 kg, dhe i projektuar e i dizajnuar për transportim të jo më shumë se tetë (8) udhëtarësh, përveç shoferit.** Automjetit në këtë kategori mund t'i bashkëngjitet një rimorkio e cila është me masën më të madhe të lejuar (maksimale të autorizuar) deri në 750 kg; e plotëson këtë kriter të Autoriteti Kontraktues.

Gjithashtu mjete transportues i ofruar nga OE me 9 ulëse është në pajtim me **LIGJIN Nr. 05/L-088 PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR, neni 3 paragrafi 1.8 Automjet udhëtarësh - mjet që shërben për transport të personave, i cili përveq ulëses së shoferit ka më së shumti tetë (8) ulëse;**



CRA/YPB/VRC 0762088

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e "Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve –Lot 4 " Ku vendi i Komunes se Prishtinës



## Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues Autotaxi “Bujar Stublla”-Podujeve të aprovohet si e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.1), të anulohet Njoftimi mbi vendimin e AK dhe rekomandon që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.